

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Italia zgjat kontrollet kufitare me Spanjën, Madridi: Absurde dhe e panevojshme - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/italia-zgjat-kontrollet-kufitare-me-spanjen-madridi-absurde-dhe-e-panevojshme/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 17:55:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 17:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d12d16496e56e007429991827a8453d5ab7230b561de6eb3653d2a6dc35df180
TEKSTI	599d831d132cfe993fb85ede1b46f4a7050c4e6776c09594ea60a9c59bc7af95
PAMJA	6c1590c035aaefa8ef2e2e933b9af6e2076332f4434ba99200f72adcee068471

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	67368a2ecc98c5095f153172c1e27d64535fadaa383dac86f67fcfb42be49e16
E MËPARSHMJA	85b4085d770fc7ed553974ad34c0d697f0b424b5598da4de2d6cf5eb2f2a9e60
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/67368a2ecc98c5095f153172c1e27d64535fadaa383dac86f67fcfb42be49e16>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Italia zgjat kontrollet kufitare me Spanjën, Madridi: Absurde dhe e panevojshme

BOTË

Demo

Italia zgjat kontrollet kufitare me Spanjën, Madridi: Absurde dhe e panevojshme

SEPTEMBER 15, 2026



Italia ka vendosur të zgjasë edhe për 15 ditë pezullimin e zbatimit të Marrëveshjes së Shengenit me Spanjën, duke vijuar kontrollet në kufijtë ajrorë dhe detarë mes dy vendeve. Masa, e cila hyri fillimisht në fuqi më 1 gusht, është marrë me vendim të ministrit të Brendshëm italian, Matteo Piantedosi.

Sipas Ministrisë së Brendshme italiane, zgjatja e kontrolleve është konsideruar e nevojshme pas vlerësimit të situatës nga Komiteti për Analizën e Imigracionit dhe Sigurisë Kufitare. Ky organ ka konstatuar se vijojnë të jenë të pranishme rreziqe të larta për sigurinë e brendshme, si dhe një kërcënim potencial për shkak të mundësisë së infiltrimit terrorist.

Ministri i Jashtëm italian, Antonio Tajani, ka mohuar se vendimi lidhet me ndonjë qëndrim politik ndaj Spanjës, duke e argumentuar atë me nevojën për forcimin e sigurisë kufitare dhe të brendshme.

“Ky nuk është një qëndrim kundër askujt, nuk është një qëndrim politik. Problemi ynë është siguri i sigurisë së brendshme dhe kufitare. Ne nuk kemi kufi me Spanjën; ka anije dhe aeroplanë që mbërrijnë nga Spanja, dhe mendoj se kjo është e drejtë për sa kohë që situata në Ceuta mbetet kaq dramatike”, deklaroi Tajani.

Ai shtoi se zhvillimet në Ceuta nuk duhet të nënvlerësohen dhe se Italia duhet të marrë masa për të garantuar sigurinë e kufijve të saj.

Vendimi i Romës ka shkaktuar reagim të fortë në Madrid. Ministri i Jashtëm spanjoll, José Manuel Albares, e kritikoi masën gjatë një seance në Senat, duke e cilësuar të pajustificuar.

“Është absurde, e padobishme dhe një turp. Minon frymën dhe filozofinë e asaj që do të thotë të quhemi partner evropian”, deklaroi Albares.

Sipas tij, nuk ekziston asnjë kërcënim ndaj integritetit të zonës Shengen nga situata në Ceuta dhe Melilla.

“Nuk ka rrezik për integritetin e zonës Shengen nga Ceuta dhe Melilla. Qeveria italiane e di këtë, por po veprojnë si udhëheqës politikë të partive dhe jo si udhëheqës evropianë të aftë për t'u përballur me rrethanat”, u shpreh ministri spanjoll.

Përplasja mes dy vendeve anëtare të BE-së vjen në një kohë kur kontrolli i kufijve dhe çështjet e sigurisë po marrin një rëndësi gjithnjë e më të madhe në Evropë, ndërsa Roma dhe Madridi kanë qëndrime të ndryshme mbi mënyrën se si duhet të menaxhohen kërcënimet e mundshme në hapësirën Shengen.

SHARE.



Postimet e reja

Aktori i njohur “Home alone” përlozet në Emm...

SEPTEMBER 15, 2026

Haga në prag të verdiktit, qindra shqiptarë...

SEPTEMBER 15, 2026

Arrestohet në Vjenë trafikanti shqiptar, i...

SEPTEMBER 15, 2026

Fundi i një epoke, Messi drejt lamtumirës me...

SEPTEMBER 15, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Pas shpalljes së listës së fituesve të “Grant 2026” kanë nisur të dalin rastet ku...

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe “problematikët”

Na ndiq

Facebook

Instagram

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu